



Komuna e Obiliqit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 11-1334
Br.

Data 25.09.2023
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ

Për:	Zyrën Kombëtare të Auditimit
Kopje:	Kryesuesi i Kuvendit Komunal Obiliq
Nga:	Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi
Datë:	25.09.2023



RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit 2022

Në bazë të nenit 14, pika 5 e Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit (Rreg.Nr.1/63, datë: 21.06.2019), në fuqi që nga qershori 2019, ku thuhet se: *Pas hartimit të planit të veprimit, entiteti i audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit/aksionarit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Raportet dorëzohen dy herë në vit, respektivisht deri më 30 shtator dhe 15 mars.*

Prandaj, në përgjigje të kësaj kërkesë, Komuna e Obiliqit ka përgatitur këtë raport lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2022 dhe rekomandimeve të periudhave të mëhershme.

I njëjti dokument i dërgohet Kryesuesit të Kuvendit Komunal për ta vendos në rend të ditës për mbledhjen e ardhshme.

**RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PASQYRAT FINANCIARE 2022,
KOMUNA E OBILIQIT**

Raportimi për afatin 30 shtator 2023

Nr. Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1 Subvencionet dhe transferet	Sipas nenit 2.1 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatës Jo Qeveritare (OJQ), përcakton që dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga çdo organizatë buxhetore e cila financon projektet dhe programet e OJQ-ve, të cilat janë aplikues apo partner në aplikimet, sipas një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve të OJQ-ve, dhe të cilat i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje. Në dy raste janë ekzekutuar pagesa pa pasur shpallje publike. Rasti i parë ishte ekzekutuar në bazë të vendimit të Kuvendit komunal në shumë prej 30,000€, dhe rasti i dytë përmes vendimit	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve do të respektohen kërkesat e dala nga rregullorja, ashtu që mbështetja financiare për OJQ-të, të bëhet me thirrje publike sipas kriterëve të përcaktuar me rregullore.	Kryetari ka nxjerr vendimet e duhura, ka përcjell punën e komisioneve dhe ka pranuar raportet e dala së bashku me listën përfutuese, për secilë thirrje publike, në drejtorinë gjegjëse, bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi. (dëshmi gjeni lingjet e thirrjeve publike në webfaqet e komunës dhe vendimet, raportet dhe punën e komisioneve, të protokolluara në arkhivën e komunës).	I zbatuar	Me kordinim mes drejtorive dhe kuvendit komunal janë tejkalluar sfidat e viteve paraprake.

	<p>të Kryetarit në shumë prej 1,000€. Bazuar në kriteret dhe procedurat për financimin e OJQ-ve, komuna nuk ka kërkuar vërtetimin tatimor mbi kryerjen e obligimeve ndaj ATK-së. Për rastin e parë, sipas të dhënave të thesarit, vërehet se OJQ kishte obligime tatimore dhe me rastin e pagesës ATK ka aplikuar ndalesën në Thesar, dhe OJQ ka përfutur vetëm shumën prej 27,717€. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesave të kontrolleve adekuate si dhe mos përgjegjësisë së komunës për të zbatuar kriteret sipas kërkesave ligjore.</p>		<p>Kryetari duhet të forcoj kontrolltet e brendshme duke e rrit mbikëqyrjen dhe verifikimin e rregullit të raporteve të deyrimeve të papaguara, njëheri duhet të siguroj që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.</p>	<p>Kryetari përmes drejtorive dhe komisioneve gjegjëse ka rregulluar procesin e rregullit të pagesave me kohë nga të dy kategoritë financiare sa i përketë furnizimeve dhe projekteve kapitale derisa përmes drejtorisë së financave dhe zyrës ligjore, ka kërkuar kordinim dhe përcjellje të vazhdueshme në rastet gjyqësore, për aq sa kompetenca i mbulon</p>	<p>Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar (në proces)</p>	<p>Megenëse asnjë herë dhe në asnjë rast/lënd nuk mund të kemi as për së afërmi njoftim se kur mund të përfundoj një proces gjyqësor (sepse kemi pasur raste kur periudha kohore ka zgjatë deri mbi tri vite), e konsiderojmë sfidë edhe në të ardhmen sepse kjo procedurë i</p>
<p>2</p>	<p>Obligimet kontraktuale</p>	<p>Neni 39 i LMFP, përcakton që Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i OB është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Ndërsa sipas neni 40 te LMFP, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrat të prerë nga gjykata/përmbaruesi. Si rezultat i vonesave në ekzekutimin e pagesave, nga</p>	<p>Kryetari duhet të forcoj kontrolltet e brendshme duke e rrit mbikëqyrjen dhe verifikimin e rregullit të raporteve të deyrimeve të papaguara, njëheri duhet të siguroj që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.</p>	<p>Kryetari përmes drejtorive dhe komisioneve gjegjëse ka rregulluar procesin e rregullit të pagesave me kohë nga të dy kategoritë financiare sa i përketë furnizimeve dhe projekteve kapitale derisa përmes drejtorisë së financave dhe zyrës ligjore, ka kërkuar kordinim dhe përcjellje të vazhdueshme në rastet gjyqësore, për aq sa kompetenca i mbulon</p>	<p>Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar (në proces)</p>	<p>Megenëse asnjë herë dhe në asnjë rast/lënd nuk mund të kemi as për së afërmi njoftim se kur mund të përfundoj një proces gjyqësor (sepse kemi pasur raste kur periudha kohore ka zgjatë deri mbi tri vite), e konsiderojmë sfidë edhe në të ardhmen sepse kjo procedurë i</p>

	<p>katëgoria e investimeve kapitale komuna ka paguar shumën prej 296,878€ si pasojë e vendimeve gjyqësore/përmbartimore duke përfshirë borxhin, interesat dhe shpenzimet përmbartimore në shumë prej 120,554€.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim jo i mirë financiar lidhur me detyrimet e papaguara.</p>		<p>këto diktatore, megjithatë kjo mbetet sfiduese edhe në të ardhmen.</p>		<p>tejkalon përgjegjësitë dhe kompetencat tona (megjë përfundimin e saj e jep Vendimi përfundimtar i gjykatës).</p>
<p>3 Prona komunale</p>	<p>Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 23 përcakton se pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, pronat i kthehet komunës dhe kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përkthyer gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen. Më tej, pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, mund të i vazhdohet afati në bazë të</p>	<p>Kryetari të siguroj që të gjitha pronat pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, pronat i kthehet komunës. Po ashtu, të siguroj që të zhvillohen procedurat përkatëse për dhënien e tyre në shfrytëzim.</p>	<p>Kryetari përmes komisionit për dhënien e pronave në shfrytëzim, në kordinim me DPUPK dhe DEFZH Sektori i bizneseve, ka pranuar raportet për gjendjen e pronave si dhe të njejtit i ka rekomanduar rishikimin e të gjitha kontratave, duke sjell përmes komisionit dhe DPUPK-së raportin edhe para asamblesë komunale. (dëshmi keni rendin e ditës së seancave të kuvendit komunal si dhe procesverbalet së bashku me raportet, marrëveshja me</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Sfiduese ka qenë koha deri në aprovimin e Planit Zhvillimor si dhe sfidë mbetet situata ekonomike.</p>

	<p>performances. Pesë kontrata të lidhura për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të pronave të komunës u kishte përfunduar afati i përcaktuar në kontratë (2009-2011). Për më tepër komuna nuk kishte zhvilluar procedura të cilat kërkohen sipas rregullores për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale apo vazhdim të afatit të shfrytëzimit, por kishte lejuar operatorët ekonomik të shfrytëzojnë pronën pa marrëveshje kontraktuale. Prej tyre, në dy raste komuna i kishte faturuar OE ndërsa në tri raste nuk kishte faturuar OE për shfrytëzim të pronës komunale. Mungesa e monitorimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim ishte shkak që këto prona të shfrytëzohen pa kontratë dhe të mos rjedhin përfitime ekonomike nga përdorimi i tyre.</p>		<p>përmbaruesin si dhe vendimet e komisionit përgjegjës).</p>		
4	<p>Prokurimi publik</p> <p>Neni 56.15 Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parashoh “Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit” artikull” në mënyrë</p>	<p>Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave publike kornizë me çmim</p>	<p>Kryetari, përmes njësi ve kërkuese së bashku me zyrën e prokurimit ka ngrit kontrollet duke angazhuar edhe komisionet/menaxherët e secilës kontratë në mënyrë që mos të kemi</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Nuk kemi pasur.</p>

		<p>që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pragu apo taveni plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veurave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi". Komuna me datën 20.10.2020 kishte lidhur kontratë publike komizë me çmim për njësi për "Rrënimin i objekteve, pastrimi i mbeburinave ilegale, pastrimi i shtirrit të përrockave lumenjve dhe shërbimeve tjera publike në raste emergjente" në vlerë të parashikuar prej 96,505€. Ne kemi vërejtur se komuna kishte bërë tejkalim të kontratës për 271,258€. Kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit jo të mirë të kontratës si dhe certifikimit të pagesës jo ne pajtim me kërkesat ligjore.</p>	<p>për njësi në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.</p>	<p>përsëritje dhe probleme të këtyre natyrave.(dëshmit i gjeni përmes kontratave të ngjashme të bashkangjitura me dokumentacionet e rekomanduar).</p>		<p>Sfidë mbetet mungesa e stafit në disa fusha specifike.</p>
5	<p>Prokurimi publik</p>	<p>Neni 40.1 e Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik shkruan se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se komisioni për vlerësim bënë vlerësimin e duhur</p>	<p>Me bashkëpunim edhe përmes kontratës me USAID, kryetari përmes drejtorive dhe zyres së prokurimit,</p>	<p>I zbatuar</p>	

<p>përcaktuara me LPP. Po ashtu neni 40.9 shkruan se AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidogoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në rast se shuma e korigjuar është më shumë se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42. Më datën 25.10.2022 në lidhje me projektin 'Bashkëfinancim-Rehabilitimi i infrastrukturës fizike të komunitetit Rom, Ashkali, dhe Egjiptian në Plenetinë'' është pranuar dhe paguar fatura në shumë prej 104,359€ në emër të situacionit të parë. Kontrata për këtë projekt ishte lidhur në shumë prej 249,168€ më datën 09.09.2022. Sipas dokumentacionit të rishikuar shihet se ky projekt është ndërprerë nga komuna si rezultat i gabimeve të gjetura nga bashkëfinancuesi MAPL në paramasën e operatorit ekonomik. Gabimet e konstatuara nga MAPL ishin rreth 9%, mbi atë të lejuar sipas</p>	<p>të ofertave duke mos shmanhur gabimet aritmetikore në asnjë rast. Po ashtu duhet të kërkoj përgjegjësi nga kompania projektuese ngase kanë rriedhur ndryshime në paramasën për të cilën veç se ka paguar komuna kompaninë projektuese.</p>	<p>kanë mbajtur trajnime dhe takime të rregullta për të gjithë menaxherët dhe zyrtarët që atakohen me kontrata dhe procedura vlerësuese si dhe projekte kapitale, duke e ditur se sistemet e e-prokurimit dhe procedurat tjera përcjellëse po pësojnë ndryshime çdo vit, si pasojë e plotësimit/ndryshimeve të rregullave të prokurimit si dhe situatave tjera.</p>			

	<p>rregullave të prokurimit deri 2%. Udhëheqësia e prokurimit më datën 14.10.2022 ka njoftuar OE për shkëputjen e kontratës. Kjo ka ndodhur për shkak se komisioni i vlerësimit në kohën e ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderit nuk ka korrigjuar gabimet në paramasën e operatorit.</p>				
<p>6 Prokurimi publik</p>	<p>Rregulla financiare Nr.01/2013 neni 12 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa. Në identifikuan se: • Në gjashhtë raste (vlera e pagesave 111,753€) zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimit të faturës; dhe • Në 28 raste (vlera e pagesave 791,658€), urdhër blerjet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës. Kjo dukuri ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parashë publikë nga ana e zyrtarëve përgjegjës.</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.</p>	<p>Kryetari, në bashkëpunim me drejtorinë dhe zyrën e prokurimit, kanë rrit kontrollat dhe kanë përcjell ecurinë e pagesave duke respektuar rregullat e duhura dhe rekomandimet. (dëshmi pagesat e vitit 2023).</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Nuk kemi pasur</p>

7	NJBNI	<p>Ligji nr.06/L-114 për zyrtarët publik, neni 68 përcakton që hapja e procedurës së konkurritit shpallet nga njësia e burimeve njerëzore në ueb fagen e konkurrimeve të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ). Njoftimet dhe procedurat e rekrutimit për personelin arsimor, nuk janë zhvilluar përmes SIMBNJ-së. Në rekrutimet për mësimdhënës përvëç konkursit publik, asnjë informata të tjetër rreth procesit të rekrutimit, si lista e ngushtë, njoftimet dhe rezultatet e testit me shkrim, intervistat dhe renditja përfundimtare e kandidatëve nuk janë publikuar në SIMBNJ dhe as në ueb fagen e komunës. Kjo ka ndodhur si rezultat i funksionimit të dobët të kontrolleve brendshme dhe mos zbatimit të kërkesave ligjore për procedurat e rekrutimit të personelit arsimor.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se procesi i rekrutimit të personelit zhvillohet sipas të ligjit për zyrtarët publik. Njoftimet dhe procedurat e rekrutimit duhet të zhvillohen përmes ueb fages së konkurrimeve të SIMBNJ-së dhe ueb fages së komunës.</p>	<p>Kryetari, përmes NJBNJ-së, ka realizuar rekrutimet sipas ligjeve në fuqi. (dëshmi linjet e konkurseve në ueb fagen e komunës, njoftimet dhe vendimet e nevojshme).</p>	I zbatuar	<p>Sfidë ka qenë sistemi i SIMBNJ-së, në gjathtë mujorin e parë të vitit.</p>
8	NJBNI	<p>Rregullojta nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera, neni I, përcakton që nëpunësit civilë kanë të drejtë të kompensohen ose të marrin kohë të lirë për punën jashtë orari, nëse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë paraprakisht ka autorizuar dhe vërtetuar punën</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se punët shesë realizohen vetëm nëse paraprakisht janë autorizuar orët e punëve shesë nga mbikëqyrësi i</p>	<p>Kryetari, përmes NJBNJ dhe njësi ve kërkuese ka realizuar shtesat sipas autorizimeve dhe dokumentacionit përkatës. (dëshmi dosjet në NJBNJ)</p>	I zbatuar	<p>Sfidë nuk kemi pasur përvëç rasteve kur kemi pasur problem me sistemin të hyrje/daljeve pas ores 16:00.</p>

	<p>jashhtë orarit. Kërkesa për kompensim për punë jashhtë orarit dërgohet për aprovim tek udhëheqësi më i lartë administrativ brenda pesë (5) ditëve të punës, pas datës në të cilën janë plotësuar orët e punës jashhtë orarit. Gjatë vitit 2022, 265 punonjës ishin kompensuar për punë jashhtë orarit në vlerë 39,565€. Këta punonjës nuk ishin autorizuar paraprakisht nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Për më tepër kërkesa për kompensim për punë jashhtë orarit ishte bërë deri në tre muaj vonesë. Shkak i kësaj është mungesa e kontrolleve të brendshme dhe se ishte konsideruar si e mjaftueshme aprovimi i punëve shtesë në fund.</p>	<p>drejtpërdrejtë, dhe se kërkesa për kompensim bëhet brenda afatit të paraparë kohor.</p>			
<p>9</p>	<p>Prokurimi publik</p> <p>Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Prokurimin Publik (me ndryshime dhe plotësime) AK duhet të bëj planin e prokurimit, në të cilin identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që AK parashihet të prokurorë gjatë vitit fiskal në fjalë. Ndërsa sipas nenit 9, pika 6, e ligjit të njëjtë precizohet që nëse aktiviteti i prokurimit nuk është përfshirë në planifikimin final të prokurimit, duhet të njoftohet</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se do të merri masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashhtë</p>	<p>Kryetari, së bashku me prokurimin publik dhe njësitë kërkuese, kanë hartuar planin e prokurimit duke pasur parasysh edhe njoftimet e dhëna në njësitë e dhëna, arsyetimet e nevojshme në rastet e plotësimit/ndryshimeve si dhe realizimin sipas planifikimeve (dëshmi</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Sfidë mbeten procedurat dhe vendimet me tendencë me OSHP në shumicën e rasteve, në realizimin e planit të prokurimit.</p>

	<p>Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) të paktën 5 ditë para autorizimit të inicimit të akti viteit të prokurimit. Kontrata që ka të bëjë me organizimin e festivalit Zjarr dhe Akull në vlerë 13,600€, nuk ishte përfshirë në planin final të prokurimit dhe nuk ishte njoftuar AQP-ja siç kërkohet me LPP-në. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit dhe bashkëpunimit me njësitë tjera të cilat bëjnë kërkesat për prokurim.</p>	<p>planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP sipas kërkesave ligjore.</p>	<p>plani i prokurimit 2023 dhe dokumentacioni përcjellës)</p>		
<p>10 Prokurimi publik</p>	<p>Sipas nenit 35 të LPP, autoriteti kontraktues përfshimisht mund ta përdor procedurën e negocuar pa publikim të njoftimit për kontratë për dhënie e çdo lloji të kontratës, nëse rrethanat e arsyeve të përdorimit e kësaj procedure. Neni 52.3 Autoritet kontraktuese duhet të sigurohen se ekzistojnë rrethanat precize që i arsyeve të negociatat para se të vendoset për përdorimin e kësaj procedure. Rasti kryesor ku kjo procedure mund të përdoret është: • Kur për arsye teknike ose artistike ekziston vetëm një Operator i mundshëm ekonomik; • Për shkak të ekzistimit të të drejtave ekskluzive të autorit ose</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit aplikon procedurat e duhura të prokurimit ashtu siç parashihet me kërkesat ligjore.</p>	<p>Kryetari, përmes zyrës së prokurimit publik në bashkëpunim me zyrën ligjore kanë rishikuar rastet e tilla duke rregulluar procedurat ligjore, sipas ligjeve në fuqi.</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Nuk ka pasur.</p>

		industriale ekziston vetëm një Operator i mundshëm ekonomik; dhe • Në rastet e urgjencës ekstreme. Zyra e prokurimit ka lidhur kontratë për Përfatësimin ligjor të Komunës së Obilicqit në gjykata, më datë 13.04.2022 në vlerë 98,000€, duke përdorur procedurën e negocituar pa publikim të njoftimit për kontratë. Në këtë rast duhej përdorur procedurë e hapur, për shkak se asnjë nga kriteret e përmendura nga rregulla dhe udhëzuesi operativ nuk janë plotësuar. Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e zyrës se prokurimit për t'i respektuar kërkesat e parapara ligjore.				
11	Prokurimi publik	Ligji Nr. 04/L-042 neni 18 parashih se vlera e parashikuar e një kontrate të propozuar të punëve është e barabartë me çmimin e parashikuar që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha punët, shërbimet, produktet si dhe lëndët e tjera që mbulohen nga ajo. Më datën 24.05.2022 duke aplikuar procedurën e poentimit të çmimit, Komuna e Obilicqit ka lidhur kontratë me OE për projektin “ Shtuarja e rrugëve me zhavorr” sipas çmimit të poentuar prej 90.49€ për 3 vite. Vlera e parashikuar e tenderit	Kryetari duhet të siguroj se njësisia kërkuese do të përgatisë paramasen dhe paralogarinë sipas sasive indikative, me qëllim të shmanjës së keqpërdorimit të mundshëm nga zhvillimi i procedurave të prokurimit sipas poentimit.	Kryetari, përmes DIL dhe zyrës projektuese ka rregulluar hartimin e projekteve sipas ligjeve në fuqi, duke kontrolluar nga komisioni i pranimit/verifikimit çdo paramasë para se e njëjta të dorëzohet në zyrën e prokurimit për tenderin. (dëshmi kontrata e hartimit të projekteve si dhe vendimi i komisionit mbikqyrës/pranues)	I zbatuar	Nuk ka pasur.

	<p>për këtë projekt ishte 90,000€, e cila nuk është paraqitur në kontratë. Në dosje të tenderit nuk është specifikuar se në cilat rrugë do të shrohet zhavorri. Për më tepër, te pagesa e situacionit të parë në shumë prej 23,673€, është vërejtur se punët janë llogaritur dhe paguar për 26 rruge të ndryshme. Sipas zyrës së prokurimit, procedura e poentimit të çmimit është zhvilluar pasi njësia kërkuese nuk ka genë në gjendje te matë sasi të e porositë me zhavor.</p>				
12	<p>Shpenzimet kapitale</p> <p>Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parase publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatese te shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë. Si rezultat i planifikimit jo adekuate të buxheti nga kategoria e investimeve kapitale, komuna ka paguar 12.312€ në emër të projektit” Mirembajtja dhe rregullimi i varrezave”.</p> <p>Rrjedhimisht se llogaria e investimeve kapitale është mbivlerësuar për këtë vlerë. Kjo ka ndodhur si pasojë se projekti</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se buxheti vjetor planifikohet në kategoritë përkatese ekonomike, me tufje të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë klasifikuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë në raportimet financiare.</p>	<p>Kryetari, përmes DEFZH ka rregulluar kategoritë buxhetore me kohë. (dëshmi pasqyrat financiare)</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Nuk ka pasur.</p>

		ishite planifikuar dhe buxhetuar gabimisht.				
13	Pasuritë kapitale	<p>Me Rregulloren MF-Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, kërkohet që pasuria kapitale të regjistrohet në SIMFK, pasuria jokapitale dhe stoget të regjistrohen në sistemin e-pasuria, dhe se të gjitha pasuritë i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Gjithashu kërkohet që në fund të vitit të bëhet inventarizimi i pasurisë. Në sistemin e-pasuria nuk është llogaritur në tërësi zhvlerësimi i pasurisë jokapitale. Bazuar në të dhënat e prezantuar në vitin 2022 në aneksin e pasqyrave financiare neni 19.3.2 shihet se komuna ka prezantuar shumën 481,632€ si bruto ashtu edhe neto për pasurit jo kapitale nën 1,000€ si rezultat i mos llogaritjes së zhvlerësimit të tyre. Po ashtu, ne kemi vërejtur se tre kamion të blerë në fund të vitit me bashkëfinancim në shumë totale 203,850€, nuk ishin regjistruar në SIMKF, ndonëse ishin pranuar nga komisioni për pranim teknik. Sipas zyrtares së pasurisë, mos llogaritja e zhvlerësimit për pasuritë nën 1,000€ ka ndodhur</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë kapitale të jenë të regjistruara në regjistrin kontabel, po ashtu të sigurojë se pasuritë jo kapitale iu llogaritet zhvlerësimi sipas normave përkatëse, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.</p>	<p>Kryetari në kordinim me DAP dhe DEFZH, ka përcjell sistemin në të cilin janë përfunduar të gjitha regjistrimet me kohë ndërsa zhvlerësimet janë duke u bërë sipas planifikimeve (dëshmi raporti dhe gjendja në SIMBNJ, vendimi i komisionit të zhvlerësimit dhe raportet e tyre)</p>	<p>Pjesërisht i zbatuar</p>	<p>Sfidë ka qenë mosfunksionimi i sistemit përgjatë viteve të kaluara, si dhe pengesat e vazhdueshme në çasje.</p>

	<p>për shkak të mosfunksionimit të vetë sistemit ndërsa, mos regjistrimi i kamionetave në SIMKEF ka ndodhur për shkak të mos pranimit të dokumentacionit nga MAPL lidhur me regjistrimin e tyre në pronësi të komunës.</p>				<p>Sfidë situata ekonomike.</p>
<p>14 Llogaritë e arkëtueshme</p>	<p>Sipas nenit 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbanese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumtën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 përcakton se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave. Komuna</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.</p>	<p>Përmes DEFZH, sektori i tatimit në pronë, bashkë me zyrën ligjore kanë realizuar vërejtjet dhe procedurat sipas ligjeve në fuqi. (dëshmi raporti, vërejtjet, kontratat si dhe marrëveshjet).</p>	<p>Pjesërisht i zbatuar/në proces</p>	

		<p>nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhje e llogarive të arketueshme (LIA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Gjatë vitit 2022 edhe pse LIA-të ishin rritur për 33,386€ në krahasim me vitin paraprak, komuna nuk kishte marrë ndonjë veprim konkret për inkasimin e tyre. Pjesëmarjen më të madhe të të arkëtueshmeve e ka tatimi në pronë me 981,603€, pastaj tarifa vjetore në biznes 90,870€ dhe të tjerat 307,149€. Dobësitë e identifikuarra ishin për shkak të kontrolleve të brendshme jo adekuate dhe mungesës së veprimeve përkatëse për inkasimin e tyre.</p>				
15	NJAB	<p>Plani vjetor i auditimit priet të realizohet brenda vitit në përputhje me afatet e përcaktuara. Rregullorja QRK-Nr.01/2019, neni 11, pika 4, përcakton që drejtori i NJAB përgatit dhe dorëzon raportin e gjashhtëmujorit të parë dhe të dytë, si dhe raportin vjetor tek udhëheqësi i organizatës, komiteti i auditimit dhe NJQH më së largu deri me 15 korrik të vitit, gjegjësisht deri më 15 janar të vitit vijues. Auditori i Brendshëm (AB) gjatë vitit 2022 kishte realizuar vetëm tri auditime nga katër të</p>	<p>Kryetari duhet të vazhdojë përpjekjet për plotësimin e NJAB-së me staf të nevojshëm, me qëllim të shimit të kapaciteteve njëzore, në mënyrë që të arrihet realizimi i planit vjetor të auditimit brenda afateve të përcaktuara, dhe se kërkesat ligjore për raportim nga</p>	<p>Sipas ligjeve në fuqi, përmes NJBNj në bashkëpunim me NJAB, janë zhvilluar procedurat rekrutuese (dëshmi linku me konkursin në webfaqe, vendimi dhe konkursi). Ndërsa sipas planit vjetor NJAB ka realizuar auditimet e rregullta si dhe ka kryer raportimet sipas afateve ligjore në njësinë gjegjëse.</p>	<p>Pjesërisht i zbatuar/në proces</p>	<p>Sfidë interesimi i kandidatëve për aplikim, përgatitja dhe kriteret specifike rekrutuese!</p>

	<p>planifikuara. Aktivitetet e përfshira në njërin nga auditimet e realizuara i takojnë periudhës 01.04.2021-31.03.2021. Po ashtu, NJAB raportin për gjashëmujorin e parë e kishte dorëzuar me vonesë. Kjo ka ndodhur për shkak të kapaciteteve të kufizuara të stafit në NJAB, ndonëse Komuna ka bërë përpjekje për rekrutim të stafit për këtë njësi. Në anën tjetër, kjo është reflektuar edhe për shkak të mungesës së mbikëqyrjes vlerësimit të aktivitetit të auditimit në përmbushjen e planit nga Komiteti i Auditimit, cili gjatë vitit kishte mbajtur 3 takime (një në muajin mars dhe dy në dhjetor).</p>	<p>NJAB realizohen brenda afateve të përcaktuara me rregulloren përkatëse.</p>		
--	--	--	--	--

- Sipas Raportit të Progresit, shihet se deri tani nga pesëmbëdhjetë (15) rekomandime; Njëmbëdhjetë (11) Rekomandime janë **zbatuar** dhe katër (4) rekomandime janë **pjesërisht të zbatuar** (janë në process të zbatimit për gjatë muajve në vazhdim).